



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 12 Janar 2022

Nr: 05

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 76, DATË 31.12.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.01.2022, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: 1. Dasantila Orizaj; 2. Klejda Kusta; 3. Fatos Ormenaj; 4. Enea Qafa, përfaqësuar me deklaram në seancë nga Av. Arenc Berati

OBJEKTI: 1) Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të procedurës për këqyrjen paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore për QV 3305/2 në KZAZ nr. 65 qarku Berat, si QV e këqyruar më parë përgjatë procesit të ankimit nga subjekte zgjedhore për të cilën është dhënë vendimi nr. 88, datë 21.05.2021 i KAS. QV 3305/2 i KZAZ nr. 65 qarku Berat lidhur me



këqyrjen e fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore;

2) Pavlefshmërinë absolute të rinumërimit të fletëve të votimit për kandidatët për deputet në këqyrjen paszgjedhore në QV 3305/2, KZAZ nr. 65 qarku Berat;

3) Pavlefshmërinë absolute të tabelës së rezultateve të verifikimit paszgjedhor për kandidatët për deputet në QV 3305/2, KZAZ nr. 65 qarku Berat, “Partia Socialiste e Shqipërisë”;

4) Të shfuqizohen gjetjet e pasqyruara në raportin lidhja nr. 1 e rezultateve të verifikimit paszgjedhor për kandidatët për deputet në QV 3305/2 të KZAZ 65 qarku Berat, e pasqyruar kjo në lidhjen nr. 1 për sa i përket verifikimit dhe saktësisë së QV 3305/2 në KZAZ nr. 65 qarku Berat, nga grupi i numërimit i ngritur nga KQZ;

5) Shfuqizimin e pikës nr. 1 të vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për sa i përket QV 3305/2 të KZAZ nr. 65, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet vendimit;

6) Shfuqizimi i pikës nr. 4 lidhur për masën e propozuar “kallëzim penal” që ka të bëjë me anëtarët e grupit të numërimit në QV 3305/2 të KZAZ nr. 65 qarku Berat sipas lidhjes nr. 4 që i bashkëlidhet vendimit për numëruesit Dasantila ORIZAJ, Klejda KUSTA, Fatos ORMENAJ, Enea QAFA.

BAZË LIGJORE: Neni 21 pika 1 shkronja “b” dhe neni 124/1 pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 8 e nenit 9 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 470, datë 03.12.2021, ka miratuar raportin e administratës së KQZ-së mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor të 519 (pesëqind e nëntëmbëdhjetë) qendrave të votimit dhe raportin e saj mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e të dhënave të pajisjeve të votimit elektronik dhe dokumentacionit zgjedhor të zonës së administrimit zgjedhor nr. 65, qarku Berat.

2. Mbështetur në gjetjet e këtyre raporteve, si dhe në zbatim të parimit të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, Komisioneri i ka kërkuar KAS-it vendosjen e sanksioneve administrative ndaj një numri sekretarësh të komisioneve të qendrave të votimit si dhe në zbatim të nenit 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” ka depozituar kallëzim penal pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara ndaj një grupi anëtarësh të grupeve të numërimit.
3. Anëtarët e Grupit të Numërimit nr. 4 dhe nr. 8, të KZAZ-së nr. 65 qarku Berat, Dasantila Orizaj, Klejda Kusta, Fatos Ormenaj dhe Enea Qafa kanë depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore e cila është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore me nr. 76 regj., datë 31.12.2021, në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor.
4. KAS-i, pasi caktoi me short relatorin z. Ledio Braho, vendosi të pranojë pjesërisht për shqyrtim kërkesën ankimore lidhur me 5 pikat e para, më konkretisht sa vijon:
 - “1) Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të procedurës për këqyrjen paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore për QV 3305/2 në KZAZ nr. 65 qarku Berat, si QV e këqyrrur më parë përgjatë procesit të ankimit nga subjekte zgjedhore për të cilën është dhënë Vendimi nr. 88, datë 21.05.2021 i KAS;
 - 2) Pavlefshmërinë absolute të rinumërimit të fletëve të votimit për kandidatët për deputet në këqyrjen paszgjedhore në QV 3305/2, KZAZ nr. 65 qarku Berat;
 - 3) Pavlefshmërinë absolute të tabelës së rezultateve të verifikimit paszgjedhor për kandidatët për deputet në QV 3305/2, KZAZ nr. 65 qarku Berat, “Partia Socialiste e Shqipërisë”;
 - 4) Të shfuqizohen gjetjet e pasqyruara në raportin lidhja nr. 1 e rezultateve të verifikimit paszgjedhor për kandidatët për deputet në QV 3305/2 të KZAZ 65 qarku Berat, e pasqyruar kjo në lidhjen nr. 1 për sa i përket verifikimit dhe saktësisë së QV 3305/2 në KZAZ nr. 65 qarku Berat, nga grupi i numërimit i ngritur nga KQZ; dhe
 - 5) Shfuqizimin e pikës nr. 1 të vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për sa i përket QV 3305/2 të KZAZ nr. 65, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet vendimit;”
5. KAS-i vendosi zhvillimin e seancës së shqyrtimit administrativ në datën 12.01.2022, ora 12:00. Në seancë ishin të pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së z. Ylli Merkaç me përfaqësues të administratës së KQZ-së. Seanca u zhvillua në prezencë të subjekteve ankuese dhe avokatit të zgjedhur me deklaram prej tyre, të cilët parashtruan pretendimet dhe dhanë sqarimet e nevojshme.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ligjvënësi për herë të parë, me ndryshimet e fundit në K.Zgjedhor, parashikoi institutin e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor. Qëllimi i këtij instituti, i parashikuar në nenin 167/2 të K.Zgjedhor, është verifikimi i rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave. Në zbatim të kësaj dispozite, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me anë të udhëzimit nr. 15/2021 “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore” ka detajuar parimet dhe procedurën që do të ndiqet nga KQZ për realizimin e kësaj këqyrjeje.
2. Administrata e KQZ-së, bazuar në dispozitat e sipërcituara, nga data 14.10.2021 deri më datë 02.11.2021 zhvilloi procesin e këqyrjes paszgjedhore. Sipas Lidhjes nr. 1 “Raport mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes së materialeve zgjedhore të përdorura nga komisionet zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021” që shoqëron vendimin nr. 470, datë 3.12.2021 “Për miratimin e raporteve të mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”, citohet se këqyrja është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 167/2 të Kodit Zgjedhor dhe të udhëzimit nr. 15, datë 07.10.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore” me qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave.
3. Po nga i njëjti akt rezulton se më datë 14.10.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përzgjedhi në mënyrë rastësore 519 QV që përfaqësonin 10% të qendrave të votimit për çdo KZAZ nga 5199 QV ku ndër të tjera citohet se “Nga kjo listë nuk u përfshinë në përzgjedhjen rastësore QV të sekuestruara nga prokuroria, QV të këqyrura nga KAS gjatë procesit ankimor, si dhe QV e KZAZ Nr. 40 të cilat ju nënshtruan procesit të verifikimit të saktësisë së sistemit të votimit dhe numërimit elektronik”.



4. Për këqyrjen e kutive të votimit dhe materialeve të votimit për këto 519 QV u ngritën 8 grupe për këqyrje të cilët vlerësuan dhe administruan procesverbalet përkatëse për administrimin e informacionit. Ky proces përfundoi më datë 02.11.2021 i cili vijoi më pas me përpunimin dhe analizimin e të dhënave për përgatitjen e raportit përmbledhës mbi respektimin nga ana e komisioneve të qendrave të votimit të kërkesave procedurale gjatë procesit të votimit si dhe të saktësisë së veprimeve të grupeve të numërimit të votave përgjatë procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave.

5. Në përfundim të këtij procesi, Komisioneri miratoi Vendimin nr. 470, datë 3.12.2021 “Për miratimin e raporteve të mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021” me anë të të cilit ndër të tjera ka vendosur:

“1. Miratimin e raportit mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor të 519 (pesëqind e nëntëmbëdhjetë) qendrave të votimit sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

...

4. Të bëj kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara nga anëtarët e grupeve të numërimit sipas listës në lidhjen 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi”.

Sipas këtij vendimi, në Lidhjen 1 kreu II pika 2 të tij, ndër të tjera rezultojnë se:

“Nga procesi i këqyrjes paszgjedhore rezultoi se procesi i numërimit të votave për kandidatët e listave shumëmemërore të subjekteve zgjedhore rezultuan se:

- 83.6 % e QV-ve kanë diferencë nga 1-9 vota (434 QV nga 519 të këqyrura)
- 7.7 % e QV-ve kanë diferencë nga 10-20 vota (40 QV nga 519 të këqyrura)
- 3.7 % e QV-ve kanë diferencë 21 - 80 vota (19 QV nga 519 të këqyrura)
- 5 % e QV-ve nuk kanë diferencë (26 QV nga 519 të këqyrura).

Për shkak të numrit të subjekteve zgjedhore, numërimit të kandidatëve për çdo zonë zgjedhore është vlerësuar se marzhi i gabimit nga grupet e numërimit të votave për subjektet nuk kanë ndikuar në ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve. Ndërkohë ndryshimi i rezultateve nga 1-20 vota për kandidatët është vlerësuar se është një marzh i pranueshëm gabimi njerëzor, referuar edhe standardeve teknike për sa kohe këto diferencë nuk kanë ndikuar në ndryshim domethënës të rezultatit për kandidatë.

Në total janë 18 QV të cilat kanë diferencë nga 21 – 76 vota për kandidatë, si më poshtë:

<i>QV-0150</i>	<i>QV-1650</i>	<i>QV-2780</i>	<i>QV-4390</i>
<i>QV-0161</i>	<i>QV-1877</i>	<i>QV-2796</i>	<i>QV-2044/1</i>

QV-0162 QV-1943 QV-3664 QV-3305/2
QV-0895 QV-2039 QV-4223 QV-4247/1
QV-1532 QV-4383”.

6. Ndaj këtij vendimi, në zbatim të nenit 124/1 pika 2 të K.Zgjedhor, kanë paraqitur një kërkesë ankimore shtetasit Dasantila Orizaj, Klejda Kusta, Fatos Ormenaj dhe Enea Qafa të cilët kanë qenë respektivisht kryetar, anëtar, sekretar dhe anëtar të GNV **që ka numëruar fletët e votimit vetëm për kandidatët e subjekteve zgjedhore për QV 3305/2 që i përket KZAZ 65 Qarku Berat**. Në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, kjo kërkesë ankimore është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 76 regj, datë 31.12.2021.

Në seancën e datës 10.01.2022 e cila ishte seancë e verifikimit paraprak, KAS vendosi:

“1. Pranimin pjesërisht për shqyrtim të pikave nga 1 (një), deri 5 (pesë) të kërkesës ankimore nr. 76, datë 31.12.2021 të paraqitur nga Anëtarët e Grupit të Numërimit nr. 4 dhe nr. 8, të KZAZ-së nr. 65; Dasantila Orizaj, Klejda Kusta, Fatos Ormenaj dhe Enea Qafa.

2. Mospranimin për shqyrtim të pikës nr. 6, të kërkesës ankimore nr. 76, datë 31.12.2021”.

7. Në lidhje me pikën 6 të kërimit të ankimesve me përmbajtje *“Shfuqizimi i pikës nr. 4 lidhur për masën e propozuar “kallëzim penal” që ka të bëjë me anëtarët e grupit të numërimit në QV 3305/2 të KZAZ nr. 65 qarku Berat sipas lidhjes nr. 4 që i bashkëlidhet vendimit për numëruesit Dasantila ORIZAJ, Klejda KUSTA, Fatos ORMENAJ, Enea QAFJA”*, KAS vendosi mos ta kalonte për shqyrtim administrativ duke argumentuar se pika 4 e dispozitivit të vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 të KSHZ nuk është kompetencë e KAS për t’u shqyrtuar, por është shprehje e vullnetit të KSHZ si nëpunës publik që në zbatim të nenit 281 të K.Pr.Penale të depozitohet kallëzim penal në prokurorinë kompetente, për të gjitha rastet kur ai krijon bindjen se është vënë në dijeni të një veprë penale që ndiqet kryesisht. Vendimi objekt i këtij shqyrtimi administrativ qëndron edhe sikur pika 4 e tij të hiqet nga dispozitivi i vendimit, sikurse detyrimi i Komisionerit për të ndjekur rrugën ligjore në zbatim të K.Pr.Penale nuk shuhet edhe sikur KAS-i të shfuqizojë pikën 4 të vendimit.

8. KAS, pasi dëgjoi pretendimet e palëve, sipas të cilave ankuesit kërkuan pranimin e kërkesës ankimore dhe administrata e KQZ rrëzimin e saj, argumenton sa më poshtë vijon:

Në lidhje me tre kërkimet e para të ankimuesve me objekt:

“1) Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të procedurës për këqyrjen paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore për QV 3305/2 në KZAZ nr. 65 qarku Berat, si QV e këqyrur më parë përgjatë procesit të ankimit nga subjekte zgjedhore për të cilën është dhënë Vendimi nr. 88, datë 21.05.2021 i KAS;

2) Pavlefshmërinë absolute të rinumërimit të fletëve të votimit për kandidatët për deputet në këqyrjen paszgjedhore në QV 3305/2, KZAZ nr. 65 qarku Berat;

3) Pavlefshmërinë absolute të tabelës së rezultateve të verifikimit paszgjedhor për kandidatët për deputet në QV 3305/2, KZAZ nr. 65 qarku Berat, “Partia Socialiste e Shqipërisë”;

nisur nga pretendimet e ankuesve dhe nga natyra e kërkimeve nga të cilat rezulton se kërkimet 2 dhe 3 janë dukshëm pasojë e kërkimit nr. 1, KAS do t’i argumentojë bashkërisht.

9. Pavarësisht faktit se në kërkesën ankimore objekt i këtij shqyrtimi administrativ rezulton se janë përdorur nenet 116 dhe 117 të K.Pr.Administrative që nuk është në fuqi, nisur nga pretendimet e ankimuesve, këto pretendime do të shqyrtohen në bazë të neneve 108 dhe 109 të K.Pr.Administrative në fuqi, që respektivisht përkufizojnë aktin administrativ absolutisht të pavlefshëm (neni 108) dhe paligjshmërinë e aktit administrativ ose aktin administrativ relativisht të pavlefshëm (neni 109).

10. Argumentet që përdor pala ankimuese janë: këqyrja e një qendre votimi që është këqyrur më parë me kërkesë të subjekteve zgjedhore përgjatë procesit të ankimit (që konsiderohet nga kjo palë si shkelje procedurale); mungesa e elementeve si identifikimi i një nga numëruesve të përcaktuar nga KQZ në procesin e këqyrjes paszgjedhore si dhe mungesa e elementeve si data e plotësimit, kodet e sigurisë si dhe vulat e hapjes dhe të mbylljes (që konsiderohen nga kjo palë si mosveprime në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshëm të aktit administrativ) dhe; mosrespektimi i parimeve të hetimit administrativ të ndjekur nga KQZ në lidhje me procesin e këqyrjes paszgjedhore.

11. Në lidhje me pretendimin e parë, që lidhet me faktin që QV 3305/2 është këqyrur më parë me kërkesë të subjekteve zgjedhore përgjatë procesit të ankimit, ky fakt provohet me Vendimin nr. 88, datë 21.05.2021 “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 34, nr. 35 të partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe nr. 42 të Partisë Demokratike të Shqipërisë” të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe me aktin “Tabelë e Rezultateve për Partitë, Koalicionet, Kandidatët e Pavarur në Qendrën e Votimit” për qarkun Berat, ZAZ nr. 65, GN Nr. 5,

QV Nr. 3305/2 të plotësuar në datë 21.05.2021 nga grupi i numërimit të KQZ me anëtarë Blendi Kodra dhe Anduela Xhaferaj. Këqyrja e kutisë së materialeve zgjedhore dhe e asaj të fletëve të votimit për këtë QV (dhe e gjithë ZAZ pjesë e të cilës ishte kjo QV) është vendosur me vendim të ndërmjetëm të KAS pas kërkesës së subjektit zgjedhor partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Këtu është për t'u theksuar që pavarësisht faktit se grupi i numërimit gjatë kësaj këqyrje ka numëruar dhe ka plotësuar tabelën e sipërcituar vetëm për subjektet zgjedhore dhe jo votat parapëlqyese për kandidatët, të gjitha fletët e votimit janë nxjerrë nga zarfet e mbyllur gjatë fazës së numërimit nga GNV në KZAZ dhe janë rifitur në zarfe nga ana e numëruesve në KQZ. **Nga akti “Tabela e Rezultateve të Verifikimit Paszgjedhor për Partitë, Koalicionet, Kandidatët e Pavarur në Qendrën e Votimit” për qarkun Berat, ZAZ nr. 65, QV Nr. 3305/2 të plotësuar (pa datë plotësimi), por që është fakt i njohur botërisht për shkak të transmetimit të tij *live* në media, që këqyrja paszgjedhore është kryer në harkun kohor nga data 14.10.2021 deri në datë 02.11.2021 nga grupet e numërimit të KQZ dhe nga vendimi nr. 470, datë 3.12.2021 “Për miratimin e raporteve të mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021” i KSHZ rezulton që po kjo QV është këqyrur edhe në procesin e këqyrjes paszgjedhore në zbatim të nenit 167/2 të K.Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 15/2021 “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore” të KSHZ. Në këtë udhëzim, në kreun II pika 4 të tij parashikohet se “Nuk lejohet këqyrja e fletëve të votimit ose e materialit zgjedhor që është këqyrur më parë kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore përgjatë procesit të ankimit”. Gjatë shqyrtimit administrativ në KAS, administrata e KQZ e pranoi faktin që të gjitha ato QV të cilat i ishin nënshtruar këqyrjes/rinumërimit në fazën e procesit të ankimit pas zgjedhjeve ishin përjashtuar nga shorti nga i cili u përzgjedhën 519 QV për procesin e këqyrjes paszgjedhor, por kjo QV nuk ishte përjashtuar.**

Për të kuptuar qëllimin e kërtimeve të ankimesve do rendisim ato rezultate që i vlejné këtij shqyrtimi administrativ në rend kronologjik:

- I. Në datë **26.04.2021**, GN. Nr. 3, i përbërë nga katër anëtarë GNV të ndryshëm nga **ankimuesit**, në tabelën e rezultateve për subjektet zgjedhore ka konstatuar ndër të tjera:

357 vota të gjetura në kuti, 18 vota të pavlefshme dhe 339 vota të vlefshme

Për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë ka konstatuar 154 vota të vlefshme



- II. Në datë **29.04.2021**, GN. Nr. 08, i përbërë nga ankimesit, në tabelën e rezultateve për kandidatët për deputetë ka konstatuar ndër të tjera:

122 vota të vlefshme për kandidatët për deputetë për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë, nga të cilat 51 për kandidatin Blendi Klosi.

- III. Në datë **21.05.2021**, GN. Nr. 7, e ngritur nga KQZ për rinumërimin e fletëve të votimit gjatë fazës së ankimeve të subjekteve zgjedhore dhe e përbërë nga dy anëtarë GNV pjesë e administratës së KQZ, në tabelën e rezultateve për subjektet zgjedhore ka konstatuar ndër të tjera:

*357 vota të gjetura në kuti, 21 vota të pavlefshme dhe 336 vota të vlefshme
Për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë ka konstatuar 150 vota të vlefshme*

- IV. Në periudhën nga data **14.10.2021 deri në datë 02.11.2021** GN. Nr. 03, e ngritur nga KQZ për këqyrjen paszgjedhore në zbatim të nenit 167/2 të K.Zgjedhor dhe e përbërë nga dy anëtarë GNV pjesë e administratës së KQZ, në tabelën e rezultateve për subjektet zgjedhore ka konstatuar ndër të tjera:

*357 vota të gjetura në kuti, 21 vota të pavlefshme dhe 336 vota të vlefshme
Për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë ka konstatuar 150 vota të vlefshme*

Në tabelën e rezultateve për kandidatët për deputetë ka konstatuar ndër të tjera:

150 vota të vlefshme për kandidatët për deputetë për subjektin Partia Socialiste e Shqipërisë, nga të cilat 78 për kandidatin Blendi Klosi.

12. Në Raportin e miratuar nga KSHZ me Vendimin nr. 470, datë 3.12.2021 ka rezultuar se 3.7 % e QV-ve kanë diferencë 21 - 80 vota (19 QV nga 519 të këqyrura) në lidhje me numrin e votave të kandidatëve nga listat shumemërore, marzh ky që sipas KSHZ është konsideruar tej marzhit të pranueshëm si gabim njerëzor (1 – 20 vota). **Për këtë arsye, duke qenë se për QV 3305/2 për votat për kandidatë ka një diferencë prej 27 votash për kandidatin e Partisë Socialiste Blendi Klosi nga numërimi i kryer nga GN i përbërë nga ankuesit te numërimi i kryer nga KQZ, pjesë e procesit të këqyrjes paszgjedhore, vlen të arsyetohet nëse kjo diferencë është përgjegjësi e ankuesve (pavarësisht marzhit të saj), apo mund të vijë edhe si pasojë e ndonjë**

procedure tjetër të pagjurmueshme tashmë (pas hapjes dhe numërimit katër herë të fletëve të votimit të kësaj QV).

13. Së pari duhet theksuar se nga procesverbalet e numërimit në KZAZ rezulton se votat për subjektet zgjedhore janë numëruar nga një grup tjetër numërimi i ndryshëm nga ai i grupit të numërimit që ka numëruar votat për kandidatë. Duke qenë se janë dy grupe të ndryshme që kanë numëruar të njëjtat fletë votimi, duhet t'i referohemi procedurës që duhet të ndiqej në KZAZ gjatë procesit të numërimit. Komisioni Rregullator pranë KQZ, me anë të Vendimit nr. 8, datë 04.03.2021 "Për miratimin e Udhëzuesit për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor, në ndihmë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021" ka miratuar "Udhëzuesin për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor, në ndihmë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021".

Në kreun III pika 3 të këtij Udhëzuesi parashikohet se:

"Radha e numërimit

Numërimi nis fillimisht me votat për subjektet zgjedhore për të gjitha QV-të në rang ZAZ-je;

Numërimi i votave për kandidatët e listave shumëemërore të partive politike e koalicioneve zgjedhore, fillon vetëm pasi ka mbaruar numërimi i votave për subjektet zgjedhore të të gjitha QV-ve të ZAZ-së dhe është miratuar me vendim Tabela Përmbledhëse e Rezultateve për ZAZ-në.

Kujdes! Numërimi i votave për kandidatin e parapëlqyer nis vetëm pasi ka mbaruar numërimi i votave për subjektet zgjedhore sipas procedurës të sqaruara në vijim".

Në kreun III pika 8 të këtij Udhëzuesi parashikohet se:

"Vlerësimi i votave

Fletët e votimit ndahen nga GN-it në

- *Vota të VLEFSHME,*
- *Vota të PAVLEFSHME,*
- *Vota të Kontestuar.*

Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ ose njërin nga kandidatët e tij në fletën e votimit.

! Kur është votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor".

Në kreun III pika 10 të këtij Udhëzimi parashikohet ndër të tjera se:

“Fletët votimi, në të cilat është votuar qartësisht, vetëm për subjektin zgjedhor futen në një zarf të veçante model 06, ku shënohet emri i subjektit zgjedhor, dhe nuk hapen më gjatë procesit të numërimit të votave të kandidatit të listave shumemërore”.

Në kreun IV pika 5 të këtij Udhëzimi parashikohet ndër të tjera se:

“Procedura e numërimit të votave për kandidatët e listave shumemërore të partive dhe koalicioneve zgjedhore.

...

Numëruesi i parë nxjerr në tavolinë zarfin me fletët e votimit të subjektit të parë sipas renditjes në

fletën e votimit si dhe zarfin e votave të kontestuara. Zarfi me fletët e votimit ku është votuar qartësisht për subjektin zgjedhor nuk hapen”.

14. Nga ky Udhëzues që ka përcaktuar procedurën që do të ndiqet në KZAZ për hapjen e kutive të fletëve të votimit dhe numërimin e tyre si dhe që është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga KZAZ dhe GNV-të, rezulton se në KZAZ çdo kuti me fletë votimi është hapur dhe mbyllur dy herë, së pari për të numëruar votat për subjektet zgjedhore dhe së dyti (vetëm pas përfundimit të numërimit të votave për subjektet zgjedhore për gjithë QV-të e KZAZ-së përkatëse) për të numëruar votat për kandidatët e secilit subjekt zgjedhor garues në zgjedhje. Po ashtu, çka rezulton thelbësore për çështjen objekt shqyrtimi administrativ, GN që numëron fletët e votimit për subjektet zgjedhore (numërimi i parë) ka për detyrë që fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht, vetëm për subjektin zgjedhor t’i fusë në një zarf të veçante model 06, ku shënohet emri i subjektit zgjedhor, dhe mos t’i hapë më gjatë procesit të numërimit të votave të kandidatit të listave shumemërore. Në fazën që është kryer këqyrja paszgjedhore për QV 3305/2 kjo QV ishte hapur dhe numëruar dhe tre herë të tjera më parë nga tre grupe të ndryshme numërimi.

Fakti që në KZAZ, kanë qenë dy grupe të ndryshme numërimi që kanë numëruar fletët e votimit për subjektet zgjedhore dhe ato për kandidatë, hipotetikisht lë të hapur mundësinë që grupi i parë i numërimit, pasi ka numëruar fletët e votimit për subjektet zgjedhore të këtë futur në zarfin model 06 një numër fletësh votimi të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, numër ky që mund të jetë po aq sa është dhe diferenca mes votave të subjektit zgjedhor Partia Socialiste me atë të numrit të votave që kandidatët e saj kanë marrë sipas

numërimin që ka bërë GN i përbërë nga ankimuesit. Për aq kohë sa kanë qenë dy grupe të ndryshme numërimi që kanë numëruar votat e kësaj QV në KZAZ, ky fakt e bën të pamundur që nga këqyrja paszgjedhore të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se GN e ankimuesve ka pasur 150 vota në zarfin që mund të hapte për kandidatët apo 122 pasi edhe nëse ka pasur një zarf *model 06* ai është hapur në datë 21.05.2021 në KQZ gjatë fazës së hapjes së kutive të votimit si pjesë e shqyrtimit të ankimit administrativ për ZAZ 65 të qarkut Berat.

15. Hetimi administrativ për këtë rast konkret do të mund të mund të provonte tej dyshimit të arsyeshëm përgjegjësinë e ankimuesve nëse do të kishin qenë po ata numëruar edhe në rastin e numërimin të fletëve të votimit të subjekteve zgjedhore pasi do të mbanin përgjegjësi për një nga shkeljet alternative, atë të futjes së fletëve të votimit që kanë pasur edhe vota preferenciale në zarfin *model 06* apo atë të numërimin të pasaktë të votave të kandidatëve të listave shumemërore. Po ashtu, nëse kjo qendër votimi nuk do të ishte hapur gjatë fazës së shqyrtimit të ankimeve, GN që ka kryer këqyrjen paszgjedhore do të mund të konstatonte gjatë hapjes së kutisë së fletëve të votimit nëse ka pasur një zarf *model 06* me fletë votimi me vota preferenciale çka do të ngarkonte me përgjegjësi grupin e parë të numërimin (atë që ka numëruar fletët e votimit për subjektet zgjedhore) dhe jo atë të ankimuesve çka me të drejtë nuk duhet ta hapnin këtë zarf gjatë numërimin të fletëve të votimit për kandidatët e subjekteve zgjedhore.
16. Në kushtet kur nuk jemi përpara asnjërit prej këtyre rasteve, hipotetikisht është e mundur që diferenca prej 27 votash për kandidatin e Partisë Socialiste Blendi Klosi të ketë ardhur edhe si pasojë e veprimeve të anëtarëve të grupit të numërimin që ka numëruar fletët e votimit për subjektet zgjedhore. Kjo hipotezë është e mundur për shkak të faktit se këto 27 vota që nuk i janë reflektuar në tabelë nga ankimuesit këtij kandidati, nuk i janë shtuar asnjë kandidati tjetër. Gjatë shqyrtimit administrativ një hipotezë e tillë është pranuar si kazus i mundshëm edhe nga përfaqësuesi i administratës së KQZ
17. Në lidhje me këtë hipotezë, në rastin e qarkut Berat është për t'u theksuar që gabime të ngjashme u konstatuan edhe gjatë shqyrtimit të ankimeve për këtë qark nga subjektet zgjedhore. Më konkretisht, nga rezultatet e miratuara nga KZAZ, në ZAZ 66, QV 3324 dhe 3356 rezultonin se nuk kishin asnjë votë preferenciale për kandidatët e subjekteve zgjedhore pasi anëtarët e GN kur kishin hapur kutitë e fletëve të votimit për të numëruar fletët e votimit për kandidatët i kishin gjetur të gjitha fletët e votimit në zarfin *model 06* dhe referuar Udhëzuesit të sipërcituar nuk i kishin hapur këto zarfe e për rrjedhojë i kishin plotësuar me 0 (zero) tabelat e rezultateve për

kandidatët e subjekteve zgjedhore në këto QV. Nga hapja e këtyre kutive në KQZ gjatë fazës së ankimimeve rezultoi se fletët e votimit ishin futur gabimisht në këto zarfe dhe në fakt zgjedhësit përveç subjekteve zgjedhore kishin përzgjedhur dhe kandidatë preferencialë në këto fletë votimi. **I referohemi këtij rasti për të treguar se diferenca në numrin e votave të kandidatëve të subjekteve zgjedhore si kjo objekt shqyrtimi administrativ, jo domosdoshmërisht vijnë si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të GN që ka numëruar fletët e votimit të kandidatëve, por mund të vijë si pasojë e zbatimit të Udhëzuesit nga këta të fundit (sepse nuk kanë hapur zarfin *model 06*) dhe shkeljes së tij nga anëtarët e GN që kanë numëruar fletët e votimit për subjektet zgjedhore (duke futur në zarfin *model 06* fletë votimi që kanë në përmbajtje edhe votë preferenciale për kandidatët e subjekteve zgjedhore).**

18. Nga ky rast del qartë edhe qëllimi i parashikimit në Udhëzimin Nr. 15/2021 të KSHZ se përse nuk lejohet këqyrja e fletëve të votimit ose e materialit zgjedhor që është këqyruar më parë kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore përgjatë procesit të ankimimit. Së pari për ekonomi administrative që mos të këqyret më shumë se një herë e njëjta qendër votimi, por edhe për shkak të faktit se nga një këqyrje në një tjetër mundet që të bëhet e pamundur që të hetohet një shkelje administrative e konstatuar, siç ka ndodhur edhe në rastin objekt shqyrtimi administrativ.
19. Në lidhje me procedurën e ndjekur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përveç konstatimit të shkeljes së përfshirjes në shortin e qendrave të votimit për këqyrjen paszgjedhore të një qendre votimi që është hapur gjatë fazës së ankimimeve administrative, **Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, edhe në këtë rast, si në rastin e vendimit nr. 1, datë 05.01.2022, që trajton po ashtu vendimin nr. 470, datë 03.12.2021 të KSHZ, vlerëson se nga ana e Komisionerit nuk është zhvilluar një procedurë e mirëfilltë hetimore administrative sidomos në drejtim të vlerësimit të gjithanshëm dhe të harmonizuar të provave dhe fakteve me qëllim jo vetëm verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit, vlerësimit dhe numërimit të votave, por kryesisht të ngarkimit të tyre me përgjegjësi ligjore në lidhje me funksionin e ngarkuar në procesin zgjedhor.**
20. Në këtë kontekst, procedura hetimore e zhvilluar nga KSHZ nuk është e plotë dhe nuk kënaq në mënyrë shteruese kërkesat e K.Zgjedhor dhe neneve 77 e vijues të K.Pr.Administrative, sa i përket hetimit administrativ dhe përcaktimit të përgjegjësisë konkrete për secilin nga ankimuesit që kanë qenë pjesë e GN të fletëve të votimit për kandidatë për QV 3305/2. Ky fakt, përveçse rezulton nga mosrepsektimi i një sërë parimeve të hetimit administrativ siç është njoftimi dhe dëgjimi i

palëve, del në pah edhe nga analiza e mësipërme në lidhje me shkaqet që mund të kenë sjellë diferencën e votave për kandidatin Blendi Klosi në QV 3305/2.

21. Në vijim të analizës së mësipërme KAS çmon të nevojshme të identifikojë kërkimet e palëve ankimuese në zbatim të pikës 1 të nenit 139 të K.Pr.Administrative që parashikon se *“Përveç kërkesave të nenit 100 të këtij Kodi, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankimin, përmban edhe një vlerësim të të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankim”*.

Pra, në rastin konkret është e nevojshme të përcaktohet nëse në kërkimet e tyre palët ankimuese i referohen pavlefshmërisë absolute të akteve objekt shqyrtimi administrativ apo paligjshmërisë së tyre. Duke pasur parasysh përmbajtjen e kërkesës ankimore në tërësinë e saj, pra pa u përqendruar në pjesën hyrëse të saj, pavarësisht terminologjisë së përdorur në objektin e saj (pavlefshmëri absolute dhe shfuqizim akti) apo dispozitat ligjore të referuara si shkak ligjor i saj, nga analiza në tërësi e kërkesës ankimore KAS çmon se në rastin konkret palët ankimuese kanë parashtruar njëkohësisht argumente në lidhje me paligjshmërinë e aktit, por dhe me pavlefshmërinë absolute të tij. Më konkretisht palët ankimuese ngrenë pretendime, në lidhje me procedurën e ndjekur nga KSHZ për procesin e këqyrjes paszgjedhore si dhe me elementet e detyrueshëm të aktit administrativ. Në lidhje me procedurën, pretendimet që ngrenë palët ankimuese kanë të bëjnë shortimin e QV 3305/2 në kundërshtim me vetë Udhëzimin e KSHZ nr. 15/2021 “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore” dhe me mosrespektimin e procedurës së hetimit administrativ në përputhje me K.Pr.Administrative, ndërkohë në lidhje me elementet e detyrueshëm të aktit administrativ i referohen mungesës së të dhënave për një nga numëruesit e KQZ, datës së plotësimit të tabelës si dhe kodeve të sigurisë të hapjes së kutisë, elemente këto të gjithë që i përkasin procesit të këqyrjes paszgjedhore sipas palëve ankimuese.

22. Në lidhje me procedurën e ndjekur pavarësisht se KAS i ka analizuar më sipër të gjitha shkeljet e konstatuara, që nga shortimi i një QV për këqyrje paszgjedhore që i është nënshtruar numërimit gjatë fazës së shqyrtimit të ankimeve administrative që ka sjellë si pasojë edhe pamundësinë e gjurmimit të procesit të numërimit nga KZAZ në KQZ e deri te mosrespektimi i procedurës së hetimit administrativ, KAS çmon se nuk jemi në kushtet e shkeljes flagrante të rregullave procedurale (neni 108 shkronja “a” pika “ii” e K.Pr.Administrative) për këqyrjen paszgjedhore. Shortimi i QV objekt shqyrtimi administrativ për këqyrjen paszgjedhore për aq kohë sa një ndalim i tillë nuk është i parashikuar në K.Zgjedhor, por vetëm në udhëzimin e nxjerre nga vetë KSHZ, nuk mund të nënkuptohet si shkelje flagrante e procedurës, por nga analiza e mësipërme shkelja e

kësaj procedure, duke shortuar këtë QV, ka sjellë si pasojë që përgjegjësia e ankimuesve në lidhje me diferencën e votave të mos provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm, fakt ky që u pohua edhe nga administrata e KQZ gjatë shqyrtimit administrativ. Po ashtu, edhe në lidhje me mosnjoftimin dhe mosdëgjimin e palëve gjatë hetimit administrativ, ose më saktë moskryerjen e një hetimi administrativ të mirëfilltë në zbatim të neneve 77 e vijues të K.Pr.Administrative në raport me ankimuesit, KAS e ka konstatuar sërish si shkelje procedure ashtu si edhe në vendimin nr. 1, datë 05.01.2022, por për shkak të njoftimeve që janë bërë në faqen zyrtare të internetit në KQZ, transmetimeve *live* të të gjithë procesit të këqyrjes paszgjedhore apo dhe në edicione informative, ka qenë e mundur që vetë palët ankimuese ta ndiqnin si proces këqyrjen paszgjedhore të QV 3305/2. Po ashtu partitë politike që i kanë propozuar si anëtarë të GNV-ve ankimuesit kanë qenë të ftuara për ta ndjekur procesin dhe të garantonin një proces të drejtë të këqyrjes paszgjedhore. Të gjitha këto garanci edhe pse nuk i përmbushin plotësisht garancitë e një hetimi administrativ në përputhje me K.Pr.Administrative, nuk e shndërrojnë atë në shkelje flagrante të procedurës.

23. Të gjithë këto elementë të shkeljes së procedurës, pavarësisht se nuk konsiderohen si shkelje që klasifikohen në fushën e nenit 108 të K.Pr.Administrative (pavlefshmëri absolute), konsiderohen si shkelje të lidhura me procedurën administrative në kuptim të shkronjës “b” të nenit 109 të K.Pr.Administrative (pavlefshmëri relative).
24. Në lidhje me pretendimet për elementet e detyrueshëm të aktit administrativ, mungesa e të cilëve që po ashtu konsiderohen si shkak për pavlefshmëri relative, gjatë shqyrtimit administrativ u provua se gjatë këqyrjes paszgjedhore, tabelat e rezultateve i përmbushin të gjithë elementët e detyrueshëm të aktit administrativ. Në lidhje me datën, pavarësisht se nuk është plotësuar nga GN, është një element lehtësisht i verifikueshëm për aq kohë sa është transmetuar *live* si dhe ka qenë një proces vazhdues për të 519 qendrat e votimit.
25. Si përfundim, KAS, pas analizës së detajuar të provave dhe legjislacionit në fuqi në lidhje me procedurën e numërimit të votave në KZAZ, por dhe asaj të këqyrjes paszgjedhore, arrin në konkluzionin se kërkesa ankimore e ankimuesve është pjesërisht e bazuar në ligj e në prova, rrjedhimisht vetëm sa i përket shfuqizimit të vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për pjesën e gjetjeve të raportit lidhur me QV-në nr. 3305/2, KZAZ nr. 65.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1, të nenit 30, të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore nr. 76, datë 31.12.2021 të paraqitur nga Anëtarët e Grupit të Numërimit nr. 4 dhe nr. 8 të KZAZ-së nr. 65; Dasantila Orizaj, Klejda Kusta, Fatos Ormenaj dhe Enea Qafa.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vetëm për pjesën e gjetjeve të raportit lidhur me QV-në nr. 3305/2, KZAZ nr. 65;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ledio **BRAHO** - **Relator**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Elvis **ÇEFA** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Koli **BELE** - **Anëtar**